



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr. 2587/Prot  
11

Tiranë, më 02/10/2020

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

**SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE \_\_\_\_\_**  
**DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK \_\_\_\_\_**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, i ndryshuar me Urdhërin nr.107, datë 13.08.2020 dhe shkresës nr.08 prot, datë 05.10.2020 “Njoftim për vend të lira pune” të Shkollës Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec, protokolluar në AKPA me nr.2587 prot, datë 06.10.2020,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të lëvizjes paralele për personelin mësimdhënës të formimit praktik në Shkollën Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec për pozicionin:

- Një mësimdhënës i formimit praktik në drejtimin Mekanik
- 1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në Shkollën Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në Shkollën Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose të nivelit *bachelor* në një nga profilet, që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

## 2. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Shkollës Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec,. Afati i njoftimit fillon më datë 09.10.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Shkolla Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionin:

- Një mësimdhënës i formimit praktik në drejtimin Mekanik në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Shkolla Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës Teknike–Profesionale “Enver Qiraxhi” Pogradec.

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**



**Elira DEMIRAJ**